



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria – Vlada – Government*

**Ministria e Shëndetësisë - Ministarstvo zdravstva - Ministry of Health**

Divizioni i Prokurimit/Divizia Nabavke/Procurement Division

Prishtine datë, 21.07.2025

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Ministrisë se Shëndetësisë, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit per Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 të Rregullores per Prokurim Publik të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas tri **kërkesave për ri-shqyrtim** të datës **17.07.2025**, të parashtruar nga oe **NIL ARCHITECTS SH.P.K.** dhe nga oe **ENG Construction SH.P.K.**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “**Ndërtimin e Objektit te Spitalit te përgjithshëm ne Ferizaj - vazhdim projekti**” me nr. prokurimi 206-25-80-5-1-1, nxjerr:

**V E N D I M**

- I. **REFUZOHEN**, si te jashtafatshme dhe te pa bazuara kërkesat për ri-shqyrtim te operatoreve ekonomik NIL ARCHITECTS SH.P.K. dhe ENG Construction SH.P.K., lidhur me aktivitetin e prokurimit “**Ndërtimin e Objektit te Spitalit te përgjithshëm ne Ferizaj - vazhdim projekti**” me nr. prokurimi 206-25-80-5-1-1 kundër Njoftimit për Kontratë të datës 03.04.2025 te publikuar ne platformën elektronike.
- II. **Vërtetohet**, Njoftimi për Kontratë i datës 03.04.2025, duke përfshirë edhe korrigimet B54;
- III. Autoriteti Kontraktues, sipas një ankesë paraprake ka vendosur te zbus kerkesen nr. 2, te Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare 8.1 & 8.2 dhe do te publikoj edhe një Njoftim korrigimi B54;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elekronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

**A r s y e t i m**

Operatoret Ekonomik NIL ARCHITECTS SH.P.K. dhe nga oe ENG Construction SH.P.K., me datën 17.07.2025, kane parashtruar kërkesa për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “**Ndërtimin e Objektit te Spitalit te përgjithshëm ne Ferizaj - vazhdim projekti**” me nr. prokurimi 206-25-80-5-1-1. Autoriteti Kontraktues, me datën 18.07.2025, ka shqyrtuar kërkesat në fjalë si më poshtë:

**Dispozitat e LPP-së që supozohet të janë shkelur nga AK sipas OE NIL ARCHITECTS SH.P.K.**

Diskriminimi i operatoreve ekonomik

### **Dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga AK sipas OE ENG Construction SH.P.K.:**

Neni 9 – Proporcionaliteti dhe objektiviteti në përgatitjen e dokumenteve të tenderit

Neni 13 – Transparency

Neni 15, pika 6 e Ligjit Nr. 162/2020 – Zgjatja e afatit për dorëzimin e ofertave

### **Pretendimi ankimore te OE NIL ARCHITECTS SH.P.K.**

Ne, në cilësinë e operatorit të interesuar për pjesëmarrje në procedurat e tenderimit të shpallura nga Ministria e Shëndetësisë për projektin e sipërpërmendor, ju drejtoheni përmes kësaj kërkesë zyrtare për rishqyrtim të kushteve të përcaktuara në dosjen e tenderit, pas ndryshimeve të fundit të bëra nga ana juaj.

#### **Problematika aktuale: Rritja e kriterieve ekonomike pas largimit të një kushti diskriminues**

Megjithatë, gjatë rishqyrtimit të dokumenteve të reja të tenderit, kemi vërejtur me shqetësim se në vend të lehtësimit real të kushteve, janë bërë ndryshime të tjera që i bëjnë kriteret edhe më të ashpra dhe përjashtuese, konkretisht:

Kërkesa për qarkullim financiar në tre vitet e fundit është rritur nga 40,000,000 € në 45,000,000 €.

Kërkesa për vlerë të punëve të përfunduara në periudhën e njëjtë është rritur nga 30,000,000 € në 35,000,000 €.

Këto rritje nuk janë të justifikuara në raport me natyrën, kompleksitetin dhe vlerën e kontratës, e cila është 27,973,970.95 €, dhe rrjedhimisht, janë në kundërshtim me parimin e proporcionalitetit të kërkuesave në raport me objektin e kontratës.

#### **Vlerësimi ligjor dhe shkeljet që pasojnë**

Sipas parimeve të përcaktuara në Ligjin për Prokurimin Publik (LPP) të Republikës së Kosovës – përkatësisht:

Neni mbi parimin e proporcionalitetit, kërkuesat duhet të jenë të lidhura drejtëpërdrejt me objektin e kontratës dhe të jenë të nevojshme për të garantuar përmbrushjen me sukses të saj.

Neni mbi konkurrencën e ndershme, kërkon që dokumentet e tenderit të mos favorizojnë apo diskriminojnë operatorë të caktuar.

Neni mbi mosdiskriminimin dhe trajtimin e barabartë, garanton akses të barabartë në prokurim për të gjithë operatorët ekonomikë të kualifikuar.

Rritja e këtyre kërkuesave ekonomike, në vend që të përfaqësojë një korrigjim në drejtim të hapjes së tregut, e kufizon më tej pjesëmarrjen e OE-ve, duke i përjashtuar ata në mënyrë indirekte përmes kriterieve financiare joproporcionale.

#### **Efekti negativ në konkurrencën e tregut**

Përmes këtij ndryshimi, Autoriteti Kontraktues nuk e ka zbutur diskriminimin fillestar, por ka ndërruar formën e tij: nga një kriter i drejtëpërdrejt favorizues (projekti spitalor prej 8 milionë €), në një ngarkesë ekonomike të pajustifikuar, që po ashtu redukton në mënyrë drastike numrin e operatorëve të kualifikueshëm.

Një qasje e tillë rrezikon që të:

Ulet ndjeshëm niveli i konkurrencës, duke shtuar gjasat për oferta më pak konkurruese dhe me kosto më të larta për autoritetin.

Favorizojë një ose disa operatorë me kapacitete financiare të jashtëzakonshme, duke cenuar barazinë në pjesëmarrje.

## Kërkesë konkrete

Bazuar në sa më sipër, kërkojmë nga Autoriteti Kontraktues:

Të rishikojë dhe reduktojë kriteret ekonomike-financiare në një nivel të arsyeshëm, proporcional me objektin e kontratës, duke rivendosur vlerat fillestare (ose të ngjashme) prej 40 milionë € për qarkullim dhe 30 milionë € për punë të përfunduara, ose Të argumentojë në mënyrë të hollësishme dhe të dokumentuar nevojën reale dhe të ligjshme përritjen e këtyre kritereve, në përputhje me rregullat e prokurimit publik.

Ne theksojmë përkushtimin tonë për pjesëmarrje në mënyrë të barabartë dhe transparente në këtë procedurë, si dhe ruajmë të drejtën për të ndjekur të gjitha mjetet ligjore nëse kjo kërkesë nuk trajtohet në mënyrë të drejtë dhe objektive.

**Përveç ashpërsimit të kritereve ekonomike, një çështje tjetër serioze është edhe interpretimi tepër i ngushtë i termit "kontrata të ngjashme", duke përashtuar padrejtësisht një gamë të gjerë të projekteve ndërtimore që, sipas legjisacionit në fuqi, hyjnë plotësisht në kuadër të grupit të ndërtimit.**

Sipas Ligjit për Ndërtim (Ligji Nr. 04/L-110) dhe udhëzimeve administrative në fuqi:

"Punët ndërtimore përfshijnë ndërtimin e strukturave fizike, përfshirë ndërtesa dhe infrastrukturë, siç janë rrugët, urat, ujësjellësit, kanalizimet dhe objektet tjera civile."

Pra, projekte të tillë si:

Ndërtimi i rrugëve dhe urave

Sistemet e ujësjellësit dhe kanalizimit

Punët infrastrukturore civile në përgjithësi

duhet të konsiderohen plotësisht të vlefshme si "kontrata të ngjashme", sepse:

Përbëjnë pjesë përbërëse të fushës së ndërtimit sipas përcaktimeve ligjore dhe teknike

Përputhen me natyrën e punëve që kerkohen edhe në vet projektin konkret, i cili përfshin punë infrastrukturore të ngjashme (p.sh. rrugë brenda oborrit të objektit, ujësjellës, kanalizim, rrjet i jashtëm elektrik, etj.).

Për arsyen sepse punët të cilat cilësohen si pjesë e grupit të ndërtimit përfshijnë:

**Punët përgatitore Punët strukturore Punët ndihmëse dhe të brendshme Punët e infrastrukturës së jashtme Punët për objektet ndihmëse zPunët për mirëmbajtje ose rinovim**

Për më tepër, është jologjike dhe diskriminuese të përashtohen këto lloj punimesh kur ato jo vetëm që kerkohen në projektin për të cilin po zhvillohet tenderi, por edhe përbëjnë një pjesë të konsiderueshme të përvojës teknike që kerkohet për realizimin me sukses të kontratës.

## Efekti negativ në konkurrencë (me shtesë të re)

Në rast se autoriteti kontraktues vazhdon të aplikojë një përkufizim të ngushtë të "kontratave të ngjashme", duke përashtuar padrejtësisht projektet infrastrukturore, kjo do të rezultonte në kufizim artificial të konkurrencës, përashtim të operatorëve të kualifikuar, dhe rrezik real për dështim të tenderit për shkak të mungesës së pjesëmarrësve.

## Kërkesë konkrete (me shtesë të re)

Të përfshihen në mënyrë të qartë dhe të drejtë projektet infrastrukturore (rrugë, ura, ujësjellës, kanalizime, dhe të ngjashme) si kontrata të ngjashme të vlefshme, duke u bazuar në përkufizimet ligjore dhe natyrën e vetë projektit.

## Përfundim

Në përfundim, besojmë se objktivi i përbashkët i këtij procesi është të sigurohet përgjedhja e operatorit më të përshtatshëm për realizimin me sukses të projektit, e kjo mund të arrihet vetëm përmes një gare të ndershme dhe të hapur. Prandaj, kërkojmë që të merrni në konsideratë me seriozitet argumentet tonë dhe të ndërmerrni hapat e nevojshëm për rregullimin e dokumenteve të tenderit.

## 8. Dëmet materiale

*Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar ka shkaktuar ose kërcënues t'i u shkaktojë dëme materiale, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.*

### Mos realizim i qellimit te rritjes se kompanise, puneve dhe fitimit te parapare

### **Pretendimi ankimore te OE ENG Construction SH.P.K.:**

I nderuar Autoritet Kontraktues,

Në vijim të ankesës sonë të mëparshme dhe në përputhje me **raportin e ekspertit shqyrtaues**, i cili ka gjetur pjesërisht të bazuar **pretendimin tonë të dytë**, kërkojmë nga ana juaj që të bëni **korrigimet e nevojshme** në dosjen e tenderit, për të siguruar një garë të hapur, të ndershme dhe në përputhje me legjislacionin përkatës të prokurimit publik.

**Konkretisht, kërkojmë:**

Të rishikohet dhe korrigohen kriteri për përvojë të mëparshme, në mënyrë që të:

**Përfshihen dhe pranohen projektet e natyrës infrastrukturore**, si ujësjellës, kanalizime, punime rruge dhe elementë të tjera që përputhen me natyrën teknike të punimeve të parashikuara në këtë tender;

Të respektohet qëndrimi i ekspertit shqyrtaues, i cili ka vlerësuar se duke qenë se paramasat e punimeve përfshijnë edhe pozicione të kanalizimeve dhe ujësjellësve punime rruge dhe elementë të tjera që përputhen me natyrën teknike të punimeve të parashikuara në këtë tender, atëherë projektet e kësaj natyre duhet të pranohen si përvojë relevante.

Kërkojmë që ky **korrigim të pasqyrohet** në mënyrë **zyrtare** në dosjen e tenderit, në mënyrë që të gjithë operatorët ekonomikë të kenë të njëjtat mundësi konkurrimi, dhe procesi të mos jetë diskriminues ndaj operatorëve me përvojë të krahasueshme por në projekte të quajtura "infrastrukturore".

**Baza ligjore dhe teknike e kérkesës sonë përfshin:**

Parimet themelore të barazisë së trajtimit dhe proporcionalitetit të përcaktuara në ligjin e prokurimit publik;

**Mospërputhjen logjike dhe teknike** midis përjashtimit të përvojës infrastrukturore dhe përbajtjes së vetë dokumentacionit të tenderit (i cili përfshin punime të kësaj natyre);

**Vlerësimin profesional të ekspertit shqyrtaues**, i cili ka konstatuar se pretendimi ynë është **pjesërisht i bazuar** dhe ka rekomanduar që përvaja në projekte të kanalizimit dhe ujësjellësit të merret parasysh në kuadër të përvojës së kérkuar.

**Shtesë në lidhje me afatin e dorëzimit të ofertave:**

Gjithashtu, vëmë në dukje se Autoriteti Kontraktues, në kundërshtim me kérkesat ligjore të përcaktuara në nenin 15 të Ligjit Nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik" dhe akteve\_nënligjore në zbatim të tij, ka zgjatur afatin e fundit për dorëzimin e ofertave me **vetëm 7 ditë**, ndonëse është i detyruar të bëjë zgjatjen për të paktën 10 (dhjetë) ditë kalendarike nga momenti i publikimit të përgjigjes ose ndryshimeve në dokumentet e tenderit.

Ky veprim cënon të drejtën e operatorëve ekonomikë për të pasur një afat të arsyeshëm për rishikimin dhe përgatitjen e ofertës së tyre, sidomos në rastet kur janë bërë **ndryshime thelbësore në kriteret e pjesëmarrjes apo dokumentacionin teknik**, siç është rasti në fjalë.

### Kërkesë konkrete:

Kërkojmë nga Autoriteti Kontraktues që:

Të bëjë **zgjatjen e afatit të dorëzimit të ofertave me të paktën 10 ditë kalendarike**, duke respektuar dispozitat ligjore dhe duke siguruar kohën e nevojshme për përgatitjen e ofertave pas ndryshimeve në kriteret e pjesëmarrjes;

**Përfundimisht**, kërkojmë nga ju që të merrni në konsideratë këtë kërkesë dhe të bëni **përmirësimet përkatëse në dosjen e tenderit**, në mënyrë që procesi i prokurimit të përbushë standardet ligjore dhe teknike, duke përfshirë të gjithë operatorët ekonomikë me përvojë reale dhe të vlefshme.

### 8. Dëmet materiale – Nuk ka deklaruar.

#### **Pergjigjia e AK ne lidhje me pretendimet ankimore te oe NIL ARCHITECTS SH.P.K. dhe ENG Construction SH.P.K.:**

- Fillimi i Kerkesa juaj per Rishqyrtim eshte e pa pranueshme bazuar ne nenin 60.1 te RREGULLORES Nr. 001/2022 PËR PROKURIMIN PUBLIK, shih dispoziten:

#### **Neni 60**

#### **Paraqitja e kërkesës për rishqyrtim dhe afatet kohore**

60.1 Kërkesa për rishqyrtim duhet të përbajë të dhënat në pajtim me formularin F02 dhe duhet të dorëzohet tek autoriteti përkatës kontraktues nëpërmjet sistemit të prokurimit elektronik, funksioni “kërkesat për rishqyrtim” brenda afateve të mëposhtme:

- a) Kurdo qe kërkesa për rishqyrtim ka te bëjë me njoftimin e kontratës ose me dokumentet e tenderit se paku pesë (5) ditë para afatit të fundit për dorëzim të ofertave. Në kalkulim të afateve kohore dita e dorëzimit të ofertave është dita (0). Ky afat nuk aplikohet në rastet kur AK bën zgjatje të afatit të fundit për dorëzim te ofertave pas vendimit për refuzim te kerkeses per rishqyrtim sipas Nenit 63.1.1 të kësaj rregullore.

Hapja fillestare e ofertave ka qene e parapare per daten 28.04.2025 pastaj eshte shtyre per daten 08.05.2025 dhe me vendimin e dates 24.04.2025 jane refuzuar kerkesat per rishqyrtim dhe lenda eshte trajtuar ne OSHP.

Me daten 09.07.2025 nga OSHP eshte dhene vendimi **2025/0338** ku lenda eshte korrigjuar sipas konstatimeve te OSHP-se.

- Kërkesa juaj për rishqyrtim eshte e jashtafatshme, bazuar ne dispozitat ligjore si ne vijim.

#### **Baza Ligjore për refuzim të Kërkesës për Ri-shqyrtim**

Ligji i Prokurimit Publik në bazë të nenit 108/A – Zgjidhja e mosmarrëveshjeve, para 3. i cili thekson:

**“3. Kërkesa për shqyrtim duhet të dorëzohet tek autoriteti përkatës kontraktues, me postë ose me çdo mjet tjeter të komunikimit të lejuar me këtë ligj, brenda afateve të mëposhtme:**

Operatori Ekonomik ankues ka dorëzuar Kërkesë për rishqyrtim me datë 17.07.2025 ne ora 13:48, ndërsa hapja e ofertave pas korrigjimit te dt. 15.07.2025 eshte parapare me datën 22.07.2025.

Dita e Kërkesës për rishqyrtim, data 17.07.2025 eshte dita zero (0) sipas nenit 63.2 te RRPP;

Dita e parë (1) eshte 18.07.2025, dita e dyte eshte 19.07.2025, dita e trete eshte 20.07.2025, dita e katërt eshte 21.07.2025, dita e peste eshte dita e hapjes se ofertave 22.04.2025.

Sipas nenit 60.1(a) Dita e dorëzimit te ofertave është dita zero (0), qe i bie se janë vetëm kater dite ne mes këtij afati.

Duke u bazuar në dispozitat e nenit 108/a par.3 dhe 3.2. OE ankimor ka lëshuar afatin ligjor (ius strictum) për të parashtruar ankesë pasi që **ka parashtruar ankesë pas afatit te fundit te lejuar 5 dite para dorëzimit te ofertave**.

#### **Nenin 60.1(a) i Rregullave te prokurimit publik**

a) Kurdo që kërkesa për rishqyrtim ka të bëjë me njoftimin e kontratës ose me dokumentet e tenderit se paku pesë (5) ditë para afatit të fundit për dorëzim të ofertave. Në kalkulim të afateve kohore dita e dorëzimit të ofertave është dita (0). Ky afat nuk aplikohet në rastet kur AK bën zgjatje të afatit të fundit për dorëzim të ofertave pas vendimit për refuzim të kërkesës për rishqyrtim sipas Nenit 63.1.1 të kësaj rregullore.

#### **Nenin 63.2 i Rregullave te prokurimit publik**

Vendimi mbi refuzimin ose miratimin është obligativ dhe do të publikohet në sistem të prokurimit elektronik nga Zyrtari Përgjegjës i prokurimit. Në rastet kur zyrtari përgjegjës i prokurimit nuk nxjerrë vendim në lidhje me kërkesën për shqyrtim dhe nuk njofton operatorin ekonomik për afat shtesë, Operatori Ekonomik ka të drejte që të parashtroj një ankesë pranë Organit Shqyrtaus të Prokurimit pas skadimit të afatit prej 3 (tre) dite pune nga data e dorëzimit të kërkesës për rishqyrtim. **Në kalkulim të afateve kohore data e dorëzimit të kërkesës për rishqyrtim është dita (0).**

Sipas dispozitave te me sipërme, publikimi i B54 Formulari standard për korrigjimin e gabimeve ne njoftimet e publikuara i datës 24.04.2025 pas refuzimit te kërkesave për rishqyrtim, nuk e shtynë afatin ankimor për ankesa tjera.

AK hedh poshtë ankesën e parashtrua ne përputhje me nenin 108/a i LPP-se paragrafi 8.1 cili nen përcakton se:

**Autoriteti kontraktues do ta refuzojë një kërkesë për rishqyrtim kur: 8.1 kërkesa nuk dorëzohet brenda afateve kohore të përcaktuara në paragrafin 3 të këtij nenit.**

Pavaresisht dy kerkesave dhe argumenteve te lartcekura, per shkak te nje Kerkese per Rishqyrtim te adresuar me heret, AK ka vendosur per zbutjen e dy kritereve te tenderit dhe per kete gje do te procedojme me Formularin per korrigjim B54 duke e shtyre afatin per ofertim me daten **25.07.2025 ora 14:00**.

Ndryshimet jane si ne vijim:

Eshte hequr kerkesa: **Në kuadër të projekteve të ketë realizuar të paktën një kontratë me vlerë se paku tetë (8) milion euro për ndërtim ose renovim te një objekti shëndetësor (kërkohet përliderin ne rast te grupit).**

Gjithashtu eshte zbutur edhe kerkesa fillestare **"Nuk pranohen objektet individuale, projekte infrastrukturore, rruge, nënkalime, ura, ujësjellës, kanalizim, e te ngjashme"** dhe me korrigjimin e dates 15.07.2025 **Pranohen dhe objektet banesore kolektive**, ndërsa nuk pranohen projektet infrastrukturore, rrugë, ura, ujësjellës, kanalizime dhe te ngjashme.

**Korrigjohet kerkesa nr. 2, te Kérkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare 8.1 & 8.2, dhe kjo kérkesë do te jete ne formën e hartuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik në faqe 29 të ‘Udhëzues nr. 002/2024, për plotësim ndryshimin e udhëzuesit nr. 001/2023 për Prokurimin Publik, si ne vijim:**

**Kérkesa 1. Operatori ekonomik duhet të ketë të paktën tetë (8) milion Euro asete likuide financiare në llogarinë bankare ose të paktën tetë (8) milion Euro qasje për kredi në dispozicion.**

**Dëshmia dokumentare 1. Deklarata nga banka që vërteton disponueshmérinë e tetë (8) milion Euro në llogarinë bankare të kompanisë apo një vërtetim bankar (shënim premtues) që konfirmon se kompania mund të merr kredi prej tetë (8) milion EUR, nëse është e nevojshme. Data e deklaratës bankare nuk mund të jetë më herët se data e publikimit të njoftimit të kontratës dhe i referohet aktivitetit në fjalë.**

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

**Këshilla juridike:**

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.



Berat Marmullaku  
Zyrtari përgjegjës i Prokurimit